

Z. Antonio Balsamo

Z. Antonio Balsamo, shtetas i Italisë, ka diplomuar për Drejtësi në Fakultetin e Jurisprudencës, Universiteti i Palermos në Itali në dhjetor 1986. Ai specializoi në të Drejtën e Pushtetit Rajonal dhe Lokal në Universitetin e Palermos në vitin 1991.

Ai punoi si gjykatës në Gjykatën e Palermos nga viti 1995-2007 ku u mor me shqyrtimin e shumë lëndëve të rëndësishme, përfshirë këtu edhe gjykimin e Giulio Andreotti lidhur me marrëdhëniet e ndërlikuara që ekzistonin mes krimit të organizuar dhe institucioneve publike. Z. Balsamo ishte kryesues i Gjykatës e cila urdhëroi konfiskimin e pasurive, që u vlerësuan me qindra milionë euro, të Mafisë së Sicilisë në vitin 2002. Z. Balsamo është i punësuar në Gjykatën Supreme të Kasacionit në Itali që nga viti 2007, dhe është përgjegjës për trajnimin profesional të gjykatësve dhe prokurorëve të Gjykatës Supreme të Italisë. Ai është anëtar i Bordit Drejtues të Shoqatës së Gjykatësve të Italisë dhe drejtor i revistës “La Magistratura”. Ai gjithashtu është profesor i të drejtës penale në Shkollën për Specializime Pasuniversitare për profesionet juridike.

Z. Balsamo është ekspert gjyqësor i të drejtës evropiane, të drejtat e njeriut dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet kriminale. Ai ishte edhe anëtar i Këshillit Shkencor në Këshillin e Lartë Italian për Gjyqësi, i Komisionit për Reformimin e Ligjit Penal të Italisë dhe anëtar i Komisionit Shkencor Rajonal të Institutit Ndërkombëtar për Studime të larta në Shkencat Penale. Ai gjithashtu mori pjesë si konsulent ekspert në projektet e Bashkimit Evropian që kishte të bënte me reformimin e ligjit penal të Bullgarisë si the themelimin e Zyrës së Prokurorit Publik për t’u përballë me krimin e organizuar dhe korrupsionin në IRJM dhe trafikimin me njerëz në Turqi.

Ai ka edituar librin “Giurisprudenza europea e processo penale italiano” (Jurisprudenca Evropiane dhe procesi penal italian) mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ndikimin e saj në ligjin e Italisë për procedurën penale. Ai gjithashtu ka botuar një libër mbi dëshmitë nga thashethemet si dhe disa artikuj në revistat e specializuara shkencore dhe kaptina librash mbi tema të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin shtetëror dhe ndërkombëtar.

Z. Balsamo është emëruar anëtar i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it nga ushtruesi i detyrës së shefit të Misionit më 4 maj 2010, dhe është caktuar kryesues i panelit nga kolegët e tij anëtarë të panelit më 5 maj 2010.